

MA-605 MATIPOOL

Ngjitës pllakash me bazë çimentoje, ultra elastik, i modifikuar me polimere, me forcë të lartë ngjitëse, kohë hapje të zgjatur dhe pa rrëshqitje vertikale, me Fibre Strength Tech.



PAKETIMI
25kg



RAPORTI I PËRZIERJES
5.75-6.75L/25kg



KONSUMI
3-5 kg/m²

Përshkrimi

MA-605 MATIPOOL është një ngjitës pllakash me bazë çimentoje, ultra elastik, i modifikuar me polimere, me forcë të lartë ngjitëse, kohë hapje të zgjatur dhe pa rrëshqitje vertikale, me Fibre Strength Tech. Ofron forcë të lartë ngjitëse fillestare dhe përfundimtare, si dhe qëndrueshmëri ndaj lagështisë.

Fusha e Përdorimit

- Përdoret për ngjitjen e pllakave të brendshme të dyshemesë qeramike dhe porcelan në një sërë nënshtratesh si betoni, suva, etj.
- Përdoret për ngjitjen e pllakave të granitit, gurëve natyralë dhe tullave dekorative në nënshtrata të ndryshme si betoni, suva, etj., në ambiente të brendshme dhe të jashtme.
- Përdoret për dysheme me ngrohje.
- Përdoret për pishina.
- Përdoret edhe mbi sipërfaqe metalike.

Përgatitja e Sipërfaqes

Sipërfaqja që do të mbulohet me pllaka duhet të jetë pa pluhur, yndyrë, bojë, etj. Rekomandohet ta lagni sipërfaqen para aplikimit. Përdorni riparuesin MATIART në rastin e nënshtrësave të pabarabarta, për të marrë një sipërfaqe të sheshtë. Nëse është pluhurosur, fshini pjesën e pasme të pllakave me ujë.

Aplikimi

MA-605 MATIPOOL shtohet ngadalë në ujë duke e përzier vazhdimisht, derisa të formohet një pastë homogjene. Rekomandohet përdorimi i një mikseri me shpejtësi të ulët për përzierjen. Përzierja duhet të lihet të pushojë për rreth 10 minuta para se të përzieret përsëri për pak. Për të siguruar ngjitje të mirë, shpërndani llaçin mbi sipërfaqe me anën e shpatullës të sheshtë dhe dhëmbëzoni me anën e dhëmbëzuar. Madhësitë e dhëmbëve duhet të jenë të përshtatshme për përmasat e pllakave. Instaloni pllakat mbi llaçin e dhëmbëzuar brenda kësaj periudhe me presion të fortë. Kushtet klimatike të pafavorshme (temperaturë e lartë, lagështi e ulët, erë, etj.) mund ta zvogëlojnë këtë kohë. Nëse kalon kjo periudhë, duhet të hiqni llaçin. Pllakat e instaluara me MA-605 MATIPOOL nuk duhet të ekspozohen në ujë për të paktën 24 orë.

Konsumi

Konsumi është 3-5 kg/m², varësisht nga sipërfaqja.

Karakteristika



Të dhëna teknike (NE +23°C DHE 50% U.R.)

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri/E bardhë
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal të mbyllur, në një vend të thatë
Raporti I përzierjes	5.75-6.25 litra ujë / 25 kg pluhur gri 6.25-6.75 litra ujë / 25 kg pluhur I bardhë
Temperatura e aplikimit	(+5°C) - (+35°C)
Trashësia e aplikimit	Deri në 10mm
Koha e punueshmërisë	6 Orë
Rrëshqitshmëria (EN 12004-2)	≤0.5mm
Koha e hapjes (EN 12004-2)	Pas 30 minutash ≥ 0.5 N/mm ²
Forca e ngjitjes (EN 12004-2)	
- Fillestare	≥ 1 N/mm ²
- Pas ekspozimit ndaj nxehtësisë	≥ 1 N/mm ²
- Pas zhytjes në ujë	≥ 1 N/mm ²
- Pas cikleve të ngrirjes/shkrirjes	≥ 1 N/mm ²
Deformueshmëria (EN 12002)	≥ 5mm – S2 Shumë e deformueshme
Shkalla e temperaturës	(-40°C) - (+80°C)
Reagimi ndaj zjarrit	A2
Substanca të rrezikshme	Shiko SDS

MATIS Construction Chemicals

Tiranë, Albania

info@matís-eu.com

www.matis-eu.com

T: +355 69 20 94 570

THIS TECHNICAL DATA SHEET SUPERSEDES ALL PREVIOUS EDITIONS RELEVANT TO THIS PRODUCT

2/2

DISCLAIMER: The above technical data, information, recommendations and guidance are based on scientific and technical knowledge, laboratory studies and long experience. However, the above information is considered to be as indicative and should be reviewed in any case in relation to each specific application conditions. Consequently, the suitability of each product in any application must be evaluated after referring to the updated Technical Data Sheet and to the website www.matis-eu.com, as well as after contacting the technical support department, in case of necessity. Our company guarantees the quality of the product itself, whilst in any case the user/applicant is exclusively responsible for any undesirable failures after using the product.